

V E N D I M
Nr. 29/14, datë 30.10.2000

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADIO LOKALE FM PRIVATE “ABC”

SUBJEKTIT: Z. ARMAND BAZE

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.8655, datë 31.07.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë””, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri:

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit, z.ARMAND BAZE licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator lokal radio FM privat, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuence FM për një periudhë 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.